

Nr 368 Prot

Dt: 13.02.2023



Zyrës së Informacionit
Shtetërore

13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SARANDË

Nr. ... *MM*Prot.

SARANDË, më 07/02/2023

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimit të rikuperimit me forcë të detyrimeve doganore)

Drejtuar : BASHKISE DELVINË

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale...”, neni 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 4, datë 07/04/2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave - “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.6 e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në **Bashki**, Komunë, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”.

Për sa më lart, kërkojmë nga ana Juaj :

♦ “Shpalljen Publike” për një periudhë kohore jo më pak se 10 (Dhjetë) ditë të akteve administrative, vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore (Nr.58, me nr.1965/1 Prot., datë 28/10/2022; të materializuar nga ana jonë për subjektin/shtetasin “VASIL BERTI KIDHERI”, me adresë: Kopaçez, Delvinë.

Bashkëngjitur, keni kopje të vendimit të lartpërmendur .

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes të ketyre vendimeve të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Eleron GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCES DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE SARANDË

Nr. 1365/Prot.
1

Sarande, më 28 / 10 /2022

V E N D I M

Nr 58 Datë 28 . 10 . 2022

Sot ne date 28.10.2022 ,Autoriteti vendimmarës prane Deges Doganore Sarande- Qafe Bote, pasi mora ne shqyrtim proces-verbalin nr.1965 prot. Date 21.10.2022”,mbajtur nga grupi i punes i ngritur ne zbatim të *detyrave dhe rekomandimeve të lëna nga Auditit i Brendshëm*, pranë Drejtorise se Pergjithshme te Doganave me shkresen nr 9182/5 date 16.08.2022 protokolluar në Degën e Doganës Sarandë me nr 1500 prot.date 17.08.2022, ne lidhje me praktiken doganore DAV, IM-4.R- 412 datë 08.11.2021 për importimin e artikullit “Autoveturë e përdorur” nga subjekti/shtetasi ”Vasil Berti Kidheri” me ID:L00013546P :

K O N S T A T O V A:

Grupi i punës, i ngritur për këtë qëllim, mori në shqyrtim të gjithë dokumentacinin shoqerues bashkëlidhur praktikës doganore IM.4 nr R-412 date 08.11.2021. Pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur praktikës doganore IM.4 nr R-412 date 08.11.2021 te subjektit **”VASIL BERTI KIDHERI ” me ID:L00013546P**, si dhe rekomandimin e audituesve te Auditit te Brendshem te DPD për rivlersimin e artikullit “Autoveture e perdorur, Marka JEEP-G CHEROKEE,3600 cc ,Viti i prodhimit 2017” duke marre parasysh cmimin sipas të dhenave te disponueshme të buletinit ”QUATTRORUOTE”, i cili shërben per vleresimin e autoveturave te importuara vërejmë se:

- a) Doganieri i DVQ ,i cili ka bere vleresimin e deklaratës doganore IM.4 nr. R-412 date 08.11.2021 të Zyres Doganore Sarandë në aktin e inspektimit ka shkruar: *“U aplikua cmimi 19200 eur*80%= 15360 euro”* ,nderkohe qe cmimi i rekomanduar bazuar në revisten”QUATTRORUOTE është 23400 euro x 80%=18720 Euro.

b) Po ashtu fatura e shitjes nuk është shoqëruar me një deklaratë eksporti nga vendi eksportues. Si rrjedhim nuk është evidentuar një shqyrtim më i thelluar i vlerës doganore lidhur me rivlerësimin e artikullit sipas metodave të vlerësimit doganor, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 70.2/a të Kodit Doganor.

Detyrimi shtesë i llogaritur duke aplikuar çmimin e rivlersuar 18720 € (23400 € x 80%) është 82,524 leke (Tetëdhjetë e dy mijë e peseqind e njëzetë e katër).

Ne keto kushte bazuar NENIN 49, Kontrolli pas çlirimit të mallrave :

Autoritetet doganore, pas çlirimit të mallrave, mund të verifikojnë saktësinë dhe plotshmërinë e informacionit të dhënë në deklaratën doganore, deklaratën e magazinimit të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën e rieksporit ose në njoftimin rieksporit, si dhe ekzistencën, vërtetësinë, saktësinë dhe vlefshmërinë e çdo dokumenti shoqëruar.

Gjithashtu, ato mund të verifikojnë kontabilitetin e deklaruesit dhe regjistrime të tjera që lidhen me veprimet që janë kryer mbi mallrat në fjalë ose për veprimet tregtare paraprake ose veprimet në vijim që përfshijnë këto mallra. Autoritetet doganore gjithashtu mund të verifikojnë këto mallra dhe/ose të marrin mostra, nëse ekziston akoma një mundësi e tillë.

Si dhe **ne NENIN 70 ,pika 3** të KODIT DOGANOR i cili venen se :

Neni 70 Metoda dytësore për vlerësimin doganor

3. Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1, të këtij neni, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme ...

V E N D O S A

1-Subjekti/shtetasi "Vasil Berti Kidheri" me ID:L00013546P , te paguajë shumen e detyrimit shtese **82,524 leke (Tetëdhjetë e dy mijë e peseqind e njëzetë e katër).**

2-Zyra e Finances në përputhje me procedurat ligjore ne fuqi, te kryejë kontabilizimin e borxhit .

3.Zyra e Mbikqyrjes Doganore te kryejë amendimin e deklarates IM4 R-412 date 08.11.2021.

4-Sekretaria te bëjë njoftimin e subjektit.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditesh, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave , në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".



KRYETAR

Elvis KOKA

(I DELEGUAR)